

ABSTRAKT

Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti është një nga institucionet më të rëndësishme në një shtet demokratik. Kushtetuta Republikës së Kosovës i njeh Presidentit të vendit një sërë kompetencash, midis të tjerash edhe të drejtën për shpërndarjen e Parlamentit.

Qëllimi i kërkimit është analizimi i kompetencave të Presidentit në shpërndarjen e Parlamentit.

Gjithashtu është me rëndësi të përcaktohen saktë dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që përcaktojnë kompetencat konkrete dhe ekskluzive të Presidentit për shpërndarjen e parlamentit.

Me rëndësi është të përcaktohen saktë kushtet në të cilat Presidenti mund ta ndërmarr një veprim të tillë siç është shpërndarja e parlamentit, edhe çfarë pasojash sjell shpërndarja e parlamentit për shtetin e Kosovës, për demokracinë në Kosovë, si dhe për shtetin e së drejtës.

Një nga objektivat kryesorë të projektit kërkimor është të bëhet edhe një analizë e detajuar e kompetencave të Presidentit për shpërndarjen e Parlamentit në Kosovë, edhe kompetencat për shpërndarjen e parlamentit në vendet e rajonit përfshirë këtu Shqipërinë, Italinë dhe Maqedoninë.

Fjalë kyçe: Parlamenti, Presidenti, Shpërndarja e Parlamentit, Mocioni i mosbesimit etj.

Mentori: Prof Ass Dr Flamur Hyseni

Kandidati: Agim Gashnjani.